



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot.
____.____.2020

Tiranë më,

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **BOE “Polyeco SA”, Nipt: 099363280, me adrese: Km 16 Rruga Kombetare Athine-Korinth, 19300, Aspropyrgos, Greqi & “Polyeco Albania” Shpk, Nipt: K92403020S, me adrese: Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 9, Bulevardi Zogu i Pare, Rruga Maliq Muço, Nr. 1, Qendra e Biznesit STAR, Kati 4.**

Procedura e prokurimit: **Procedure e Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-50733-02-17-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Trajtimi i mbetjeve Citostatike dhe Citotoksike për vitin 2020”**; me fond limit: **8,250,000** (tetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH** dhe **9,900,000** (nëntë milion e nëntëqind mijë) **lekë me TVSH**.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: Nga data e lidhjes se kontrates deri me 31.12.2020

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike [Date 24.02.2020] [Nr: 7]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “Polyeco SA”, Nipt: 099363280 & “Polyeco Albania” Shpk, Nipt: K92403020S

Vlera: 7,050,000 (shtatë milion e pesëdhjetë mijë) **leke pa TVSH** dhe **8,460,000** (tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) **leke me TVSH**.

2. “ECO RIKIKLIM” Shpk

L61814009B

Vlera: 7,425,000 (shtatë milion e katërqind e njëzet e pesë mijë) **leke pa TVSH** dhe **8,910,000** (tetë milion e nëntëqind e dhjetë mijë) **leke me TVSH**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “ECO RIKIKLIM” Shpk

L61814009B

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të administruar nga OE në SPE, rezulton se në DST, Seksioni: Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Kapacitetin Teknik), **germa c) kërkohet që: c) Operatori ekonomik duhet te paraqesë një autodeklaratë, ku të**

*përcaktohet Këshilltari i Sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, së bashku me certifikatë të vlefshme të formimit profesional të tij, këshilltari i sigurisë duhet të jetë në marrëdhënie pune të vërtetuar me operatorin ekonomik (vërtetuar me kontratë ndërmjet palëve); **Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri. Nuk ka paraqitur Këshilltar Sigurie të certifikuar (Referuar përcaktimeve të Ligjit Nr. 118/2012 Për Transportin e Mallrave të Rrezikshme).***

- Kontrata e paraqitur me SUT është me objekt trajtim mbetjesh spitalore. Referuar legjislacionit në fuqi në RSH, trajtimi nënkupton hidroklavimin/autoklavimin e mbetjeve të rrezikshme infektive, duke i kthyer në mbetje urbane me destinacion landfillin, dhe jo asgjësimin e mbetjeve citostatike/citotoksike. Objekti i kontratës përfshin kodet sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve: 180101, 02, 03 dhe 04, konkretisht mbetje infektive sipas pikës 4 të nenit 8 të kontratës. Në këtë kuadër KVO vlerëson se nuk përmbushen kërkesat e germës a) të pikës 3.3 (Kapacitetit Teknik).
- Dokumentacioni i paraqitur për të përmbushur kërkesat e germës dh) nuk është i plotë. Skeda teknike e paraqitur në SPE si dhe Deklarata e Konformitetit të Impiantit administrohet në fotokopje, çka bie në kundërshtim me kërkesat e DST ku kërkohet që: ***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

Per sa me sipër, OE “ECO RICIKLIM” Shpk nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST nga AK, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 4, 5/c, dhe nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “Polyeco SA”**, Nipt: 099363280, me adrese: Km 16 Rruga Kombetare Athine-Korinth, 19300, Aspropyrgos, Greqi & **“Polyeco Albania” Shpk**, Nipt: K92403020S, me adrese: Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 9, Bulevardi Zogu i Pare, Rruga Maliq Muço, Nr. 1, Qendra e Biznesit STAR, Kati 4, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **7,050,000** (shtatë milion e pesëdhjetë mijë) **leke pa TVSH** dhe **8,460,000** (tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) **leke me TVSH**, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë**, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372 - Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 24.04.2020.

Ankesa: Nuk ka patur.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enkelejdi JOTI